REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 945/23
Datë/Datum 20.12.2023
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIËË BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubljanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel:+ 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH.nr. 945/23

Duke u bazuar në nenin 105 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05, L-068, si dhe Ligjin 05/ L-002, si dhe nenin 48 dhe nenin 50 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Ligji nr. 05/L-031, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "FURNIZIM ME UNIFORME POLICORE" me numër të prokurimit 214-23-8647-1-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS, Kryetari i Paneli Shqyrtues Isa Hasani më 20.12.2023, mori këtë:

KONKLUZION

I lejohet kthimi i mjeteve operatorit ekonomik MBUROYA SH.P.K sipas tarifës së paguar me parashtrimin e ankesës me numër protokolli 945/23 të datës 26.11.2023.

Arsyetim

Organi Shqyrtues i Prokurimit, me datën 07.12.2023 ka publikuar vendimin me numër të protokollit 945/23, me të cilin vendim ka hedhur si palejuar ankesën e operatorit ekonomik: "MBUROYA SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit "FURNIZIM ME UNIFORME POLICORE" me numër të prokurimit 214-23-8647-1-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS, pasi që Ankuesi kërkesën për rishqyrtim tek AK e ka parashtruar jashtë afateve ligjore.

Ne arsyetimin e vendimit thuhet "*Me tutje, Zyra e pranimit të ankesave pas pranimit të ankesës, gjatë verifikimit nëse ankesa është dorëzuar sipas rregullave dhe dispozitave ligjore, ka konstatuar se ankuesi për ankesën në fjalë nuk ka ofruar edhe dëshminë e pagesës se tarifës siç kërkohet me piken 10 paragrafi 1 të nenit 111të LPP-së.*"

OSHP sqaron se OE ankues MBUROYA SH.P.K me datën 26.11.2023 ka parashtruar ankesën kundër vendimit të AK lidhur me aktivitetin e prokurimit "FURNIZIM ME UNIFORME POLICORE" me numër të prokurimit 214-23-8647-1-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS. Ndërsa tarifën e pagesës e ka bashkangjitur me datën 30.11.2023, andaj meqë jemi njoftuar me vonesë

nga Thesari, ka ndodhur një gabim në vendimin e publikuar nga OSHP, sa i përket tarifës se pagesës andaj e njëjta korrigjohet.

Përmes këtij konkluzioni, OSHP konstaton se kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik MBUROYA SH.P.K. Ashtu që në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Pra, duke pasur parasysh të gjitha arsyet e cekura si më lartë, ndryshohet vendimi Nr.945/23 të datës 07.12.2023 sa i përket tarifës, ashtu që OE MBUROYA SH.P.K., i lejohet kthimi i tarifës së paguar me parashtrimin e ankesës në OSHP.

Paneli shqyrtues në pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

ISA HASANI

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 OE ankues

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së